



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban, autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit pas vëllimit të lartë të punëve në sektorin e inspektimeve të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në plotësimin e pozitave përkatëse përmes rekrutimit të zyrtarit/es konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:


I Autorizuari
Drejtoria e Inspeksionit
Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.Prot. 02-016/01-0026066/26
Podujevë, datë: 04.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) nr.19/2024 për procedurat për zgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësindhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar si dhe nenet 16, 19 paragrafët 1.8 dhe 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr.prot.02-112/02-0025732/26, datë 04.05.2026, nxjerrë këtë;

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "ALI HADRI " NË FSHATIN OBRANÇË KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z.Nystret Ismajli, nga Podujeva, me nr. personal [REDACTED] me kualifikim MSC i Arteve në Menaxhment;

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit në SHFMU "ALI HADRI" në fshatin Obrançe, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/shës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në marrjen një akti tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Arsimit

z. Nystret Ismajli (Njoftohet përmes DKA)

QSHQ/Arkivi

Nr. prot. 02-112/02-0026127/26
Podujevë, datë: 05.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit për artin dhe kulturën nr. 08/L-245, nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores nr.04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS), nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit "Avdush Hasani"- Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, nenin 2 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës "Avdush Hasani" nr.prot.01-640/01-0051835/21 të datës 28.06.202, merr;

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT "AVDUSH HASANI" NË PODUJEVË

Neni 1

Emërohet Këshilli Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, me mandat katër (4) vjeçar, në përbërje:

z.Xheladin Çitaku, *profesioni - Dega e Letërsisë*

z.Mehmet Breznica, *aktor*

znj.Arta Sadiku, *profesoreshë e Artit Muzikor*

znj.Venoza Zullufi, *zyrtare në Drejtorinë së Kulturës Rinisë dhe Sportit- Podujevë,*

znj.Fatmire Fusha, *profesioni - Dega e Artit Figurativ*

Kryetari/ja i Këshillit Drejtues zgjedhet konform Statutit të Teatrit dhe Rregullores së punës së Këshillit Drejtues.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet, Këshilli Drejtues, i ushtron në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa për punën e kryer kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Kryetarit të Komunës, Këshilli Drejtues i Teatrit i paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS

Anëtarëve të Këshillit (përmes DKRS)

Teatrit të Qytetit

Arkivi

Nr.Prot.02-020/05-0026144/26
Podujevë, Datë,05.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11,13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 6 paragrafi 1.3 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 7 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 të Rregullores komunale nr. prot. 01-462/01-0062841/22 datë 29.07.2022 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një(1) vit të pronës së paluajtshme të komunës dhe neneve 14, 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr;

V E N D I M PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrohen nga personat fizik dhe juridik për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim më pak se një (1) vit, si vijon:

Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në DSHPMSH-kryesues

Kujtim Zhitia, zyrtar për emergjenca në DSHPMSH- anëtar

Zanë Fazliu, zyrtar për gjeodezi në DPUMM-anëtare

Shkurta Musa, udhëheqëse e sektorit për regjistrim të bizneseve në DZHPE- anëtare

Naime Ajeti, zyrtar për emergjenca në DSHPMSH- anëtare

Kryesues i Komisionit do të jetë zyrtari nga Drejtoria të cilës i është drejtuar kërkesa për marrje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 2

Komisioni sipas nenit 1 të këtij vendimi vepron në përputhje me rregullativën përkatëse ligjore në fuqi, me theks Rregulloren komunale për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, ndër të tjera duke bërë shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e kërkesave për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, përgatitjen e raportit përfundimtar, përfshirë edhe rekomandimin për palën e përzgjedhur/përfituese së bashku me Kontratën e cila nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi i pronës.

Neni 3

Mandati i komisionit është dy (2) vite nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr. prot. 02-020/05-0006381/25 datë 29.01.2025.

U dërgohet;

Drejtoria përkatëse dhe anëtarëve të komisionit

Zyrës së Personelit

QSHQ/Arkivit

Nr.prot. 02-020/04-0026480/26

Podujevë, datë: 05.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronjat e) f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, neneve 16, 19 paragrafët 1.5; 1.6 dhe nenit 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019222/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi”, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 mars 2026, merr këtë,

V E N D I M **PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË** **AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “EKO-LLAPI” SH.A.** **NË PODUJEVË**

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A. në Podujevë, emërohet,

z.Avni Fetahu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0019222/26 të datës 31 mars 2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0026475 126
Podujevë, datë, 05.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019219/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 mars 2026, merr këtë,

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohet,

z.Vigan Salihu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0019219/26 të datës 31 mars 2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-020/04-0026477/26
Podujevë, datë, 05.05.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja l) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 nr.20) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.12 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019220/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 mars 2026, merr këtë,

V E N D I M

**PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË
AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A.
PODUJEVË**

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. - Podujevë, emërohet,

z.Shuajb Blakçori, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0019220/26 të datës 31 mars 2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-020/04-0026476/26
Podujevë, datë, 05.05.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 25 të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, nenin 4 të Rregullores me Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862, merr:

V E N D I M

Neni 1

1.1 Formohet Mekanizmi Koordinues Lokal për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjimore, në këtë përbërje:

Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës – Kryesues

Lirie Hoti Rama, U.D. Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – anëtare

Makfirete Zeka, Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale - anëtare

Naim Potoku, Udhëheqës i Shërbimeve Sociale - anëtar

Avni Fetahu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Arsimit - anëtar

Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjimore- anëtare

Venera Muçolli, U.D Drejtoreshë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-anëtare

Liman Zeqiri, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-anëtar

Zana Hamiti, Përfaqësuese nga Strehimorja - anëtare

Shqipdon Rushiti, Përfaqësues nga OJQ-anëtar

1.2. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, pjesë e Mekanizmin Koordinues Lokal janë edhe:

Mbrojtësi i Viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave – anëtar/e;

Përfaqësues nga Gjykata – anëtar/e;

Përfaqësues nga Prokuroria – anëtar/e;

Përfaqësues nga Policia – anëtar/e;

Përfaqësues nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas – anëtar/e;

Përfaqësues nga Zyra e Punësimit – anëtar/e;

Përfaqësues nga Qendra e Shëndetit Mendor – anëtar/e.

Neni 2

Detyrë dhe përgjegjësi e Mekanizmit Koordinues Lokal për mbrojtjen dhe ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore është që të veproj në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Rregullores me Nr. 01/2025 për Mekanizmin Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.

Neni 3

Zyrtare për mbështetje administrative teknike të Mekanizmit Koordinues Lokal caktohet Naime Podvorica.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;
Anëtarëve të Mekanizmit
QSHQ/Arkivit*

Nr.prot. 02-020/04-0026789/26
Podujevë, datë: 06.05.2026

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr. prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr. prot.06-400/04-00024348/26, të datës 24.04.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. Lorita Ahmeti, nga fshati Repë, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të vajzës së saj (Katana Qerimi) dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 1000€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj. Lorita Ahmeti (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr. prot. 02-400/03-0026778/26
Podujevë, datë, 06.05.2025

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës, nr. 01-020/01-0050862/18, në pajtim me Strategjinë e re për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, Planin e Veprimit 2025-2026, si dhe shkresën Nr. 0-231 të datës 30.03.2026 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, merr:

V E N D I M **PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES**

Neni 1

Themelohet Komiteti Veprues në Komunën e Podujevës, në përbërje:

Avni Fetahu, U.D - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – anëtar
Lirie Hoti Rama U.D – Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale- anëtare
Arbresha Bashota, Zyrtare Për Shërbime Sociale – anëtare
Liman Zeqiri, Shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim – anëtar
Salih Hoxha, Zyrtar Për të Drejtave të Fëmijëve – anëtar
Naime Podvorica, Zyrtare Për Barazi Gjinore - anëtare
Mimoza Restelica, Zyrtare Kryesore Financiare (me autorizim të Kryetarit) – anëtare
Xhafer Ademi, OJQ “ Qëndrimi” Komuniteti Ashkali – anëtar
Fikmete Qurkolli, OJQ “Democratic Hope”, Komuniteti Ashkali - anëtar
Muhamet Sadiku, Komuniteti Rom – anëtar
Shkurte Sejdiu, Komuniteti Ashkali – anëtare

Neni 2

Komiteti Komunal Veprues angazhohet dhe vepron në zbatimin e aktiviteteve komunale në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare, për Komunën e Podujevës, si dhe të shërbej si strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit për Qeverisje të mirë në kuadër të procesit të zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë.

Neni 3

Komitetit Komunal veprues do të udhëheqet nga Kryetari ose Nënkryetari i Komunës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/04-0016277/23 i datës 28.02.2023.

Vendimi u dërgohet:

Anëtarëve të Komitetit Komunal Veprues (përmes ZKKK)

MAPL, për njoftim

QSHQ/Arkiv

Nr.prot. 02-020/04-0027248/26
Podujevë, datë; 08.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj.Arbresha Bashota, zyrtare për shërbime sociale në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga pozita e zyrtarit për buxhet dhe financa në kuadër të Drejtorisë së cekur.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së zyrtarit për buxhet dhe financa dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E Autorizuara
Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.prot. 02/016/01-0027331/26
Podujevë, datë: 08.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0027535/26 të datës 12.05.2026, të OJQ–Shoqëria Kulturore Artistike Flaka e Llapit, merr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ-SHOQËRIA KULTURORE ARTISTIKE FLAKA E LLAPIT

Neni 1

OJQ – Shoqëria Kulturore Artistike Flaka e Llapit, për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrje në dy festivale, në Konispol dhe në Bajram Curr në Republikën e Shqipërisë mbështetet me mjete financiare në shumë 250€.

Neni 2

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidhë kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ – Shoqëria Kulturore Artistike Flaka e Llapit

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendim.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-400/03-0028595/26
Podujevë, datë 15.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 8 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publik dhe neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-020/04-0069722/25 DATË 30.10.2025

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr.prot. 02-020/04-0069722/25, datë 30.10.2025 për ngritjen e Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik, dhe atë:

Në vend të **Jehona Havolli**, anëtare e Komisionit caktohet **Ardiana Dibrani**, udhëheqëse e sektorit të pronës në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit bazë të përshkruar në nenin 1.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Të caktuarës dhe Anëtarëve të Komisionit (Përmes Kryesuesit)
Zyrës së Personelit
QSHQ/Arkivit

Nr. prot. 02-020/04-0025783/26
Podujevë, datë: 18.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L – 040, nenin 15 të Ligjit për Mbeturina nr. 04/L-060 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

VENDIM

Neni 1

Themelohet Komisioni komunal për vlerësimin e gjendjes dhe ofrimin e zgjidhjes për organizimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në territorin e Komunës së Podujevës, në këtë përbërje:

Bahri Selimi, U.D. i Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Ahmet Ahmeti, U.D. i Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Shuajb Blakqori, U.D. i Drejtorit të Inspeksionit

Neni 2

Detyra dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të analizojë gjendjen aktuale lidhur me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave; të shqyrtojë të gjitha mundësitë ligjore dhe administrative për dalje nga situata e rënduar dhe të merr masa konkrete në funksion të organizimit të menjëhershëm për grumbullimin e mbeturinave.

Neni 3

Arsyeja e formimit të këtij Komisioni është gjendja e rënduar lidhur me grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave nga ana e Kompanisë Rajonale “Pastrimi”, edhe përkundër shkresave të dërguara nga ana e Autoritetit komunal ndaj Kompanisë në fjalë, por edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve të Kompanisë për kryerje të shërbimeve të cekura më lartë si dhe ankesave të shumta lidhur me këtë çështje nga ana e qytetarëve.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot. 02-02/04-0029028/26
Podujevë, datë: 18.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-112/02-0028094/26, datë 14.05. 2026, merr;

VENDIM

PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “SHABAN SHALA“ PODUJEVË

Neni 1

z.Besnik Uka, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED] me kualifikim MSC Fakulteti Filologjik, drejtimi Gjuhë dhe Letërsi Shqipe,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët - SHFMU “Shaban Shala“ Podujevë.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit/eshës sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-112/02-0028094/26
Podujevë, datë: 18.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 16 dhe 61 parag. 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, nenet 3 parag.3, 8 dhe 15 parag. 1.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01- 016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-400/01-0062888/25, datë 29.09.2025, për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2026 dhe Parashikimet Buxhetore 2027-2028, sipas Konkursit të Drejtorisë së Arsimit nr.prot 05/130 të datës 12.03.2026, për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Podujevës për vitin akademik 2025-2026, në rekomandim nr.prot.02-400/400-0028296/26, të datës 14.05.2026 të Komisionit Ad-Hoc, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të bursave merr:

V E N D I M **PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË**

Neni 1

Treqind e njëzet e gjashtë (326) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijnë studimet në Fakultete të Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës për vitin akademik 2025-2026, u ndahet bursë në shumë të përgjithshme 118,000€ dhe atë njëqind e një (101) studentëve në drejtimet deficitare u ndahet bursë në shumë 500€, për secilin student, ndërsa dyqind e njëzet e pesë (225) studeneteve të drejtimeve tjera u ndahet bursë në shumë 300€, për secilin student.

Neni 2

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas rregullores për kushtet dhe kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

Neni 3

Pjesë përbërëse e vendimit është lista përfundimtare e përfituesve të bursave nr.05-615/03-0028287/26, datë 14.05.2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit kurse zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit në koordinimin me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit

Drejtorisë së Arsimit

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

QSHQ/Arkivi

Nr. Prot. 02-016/01-0029051/26
Podujevë, datë, 18.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b) dhe i) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.9, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 3.1 dhe 3.2 të Rregullores Komunale për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot. 01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të datës 19.05.2026, të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, merr;

VENDIM

PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE ME GJENDJE TË RËNDË SHËNDETËSORE DHE SOCIALE

Neni 1

Me këtë vendim lejohet dhënia e ndihmës financiare në shumë të përgjithshme prej njëmbëdhjetëmijë e nëntëqind euro (11,900 €) ndihmë për shtatëdhjetë e tre (73) persona me gjendje të rëndë shëndetësore dhe ekonomike - sociale për muajin prill 2026, sipas shumave individuale të paraqitura në listën e rekomanduar nga komisioni përkatës.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 3

Shuma e mjeteve individuale sipas listës bashkangjitur këtij vendimi nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022.

Neni 4

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.prot 02-0063-0029241/26
Podujevë, datë 19.05.2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3 dhe nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me Vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0014132/25 datë 07.03.2025, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencioneve, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës nr.prot.02-400/04-0029886/26, të datës 22.05.2026, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj.Egzona Mehmeti, nga fshati Siboc i Epërm, Komuna e Podujevës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve për trajtimin të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 500€.

Neni 2

Mjetet financiare sipas këtij vendimi ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë e të përmendurës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorive përkatëse.

QSHQ/Arkivit.

Znj.Egzona Mehmeti (njoftohet përmes DSHMS-së).

Nr.prot 02-400/04-0030753/26
Podujevë, datë, 26.05.2026

